



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.425/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Partesh, paraqitur kundër subjektit politik G.I. Srpska, dega në Partesh, për shkak të mbulimit të postereve, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Partesh, kështu që subjektit politik G.I. Srpska, dega në Partesh, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.11.2013, nga SLS, me të cilën pretendohet se në vendin ku G.I.Srpska ka mbajtur tubim politik me datën 01.11.2013, prej orës 16:00, disa orë më herët përsëri janë mbuluar bilbordet e kandidatit për kryetar Nenad Cvetković dhe posteret e SLS-së, me posteret dhe flamujt nga ana e subjektit politik G.I.Srpska. Parashtruesi i ankesës thekson se kjo nuk është hera e parë. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës foto si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik G.I. Srpska, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 03.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.11.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik G.I. Srpska, në të cilën theksohet se fotografitë e bashkangjitura nuk paraqesin dëshmi se aktivistet e G.I. Srpska, kanë vendosur postere, aktivistet e G.I.Srpska janë njoftuar dhe rreptësisht janë duke i respektuar të gjitha rregullat zgjedhore, poashtu në përgjigje theksohet se nuk ekziston apo nuk është paraqitur ndonjë dëshmi si audio apo video inqizim ku shihet se aktivistet e G.I.Srpska kanë mbuluar apo grisur postere të SLS-së, ndërsa deri tek materiali zgjedhor mund të vihet në mënyra të ndryshme të keqpërdorimit, si me shtypjen e paautorizuar dhe kështu mund të shkaktohet drejtpërdrejt dëmi i subjektit tjetër politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sipas pretendimeve ankimore, anëtarë të subjektit politik G.I. Srpska, kanë mbuluar bilbordet e kandidatit për kryetar Nenad Cvetković, dhe posteret e SLS-së, me posterë dhe flamuj të G.I.Srpska, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika a) të LZP, nenin 4.1 pika a) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara të subjekteve

politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që kanë të bëjnë me heqjen, mbulimin dëmtimin e ndonjë e posterit, nga ana e një subjekti tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës identifikohet qartë se posterë dhe flamuj nga subjekti G.I.Srpska kanë mbuluar posterë të subjektit politik SLS, andaj një veprim të tillë PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e ligjore të LZP-së.

Ndërsa pretendimet në përgjigjen e ankesës nga subjekti politik G.I.Srpska se fotografitë e bashkangjitura nuk paraqesin dëshmi se aktivistet e G.I.Srpska i kanë vendosur këto postere, nuk ekziston ndonjë audio apo video incizim ku shihet se këta aktivistë i kanë mbuluar apo grisur posterë të SLS-së, subjekti politik G.I.Srpska përveç këtyre thënieve në përgjigje në ankesë, nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi, që kërkohet sipas nenit 32.6 të LZP-së, se subjekti në fjalë ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët nga shkelja e këtij Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e masave të mëtejshme.

Prandaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e G.I.Srpska, është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "a" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika a) të LZP-së, ngase ka mbuluar posterë të cilët i takojnë subjektit politik SLS, dhe se subjekti politik në fjalë nuk ka bërë asnjë përpjekje serioze për ti parandaluar veprimet e tilla, me qëllim të evitimit të shkeljeve të sipërshënuara, po ashtu subjekti i njëjtë politik ka bërë shkelje të kësaj natyre edhe më herët në këto zgjedhje dhe në këtë rast konsiderohet si recidivist, pasi që edhe më parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LZP-së, PZAP, e mori si rrethanë rënduese për rritjen e dënimit, si dhe duke marrë parasysh faktorët e cituar me lartë, për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr.425/2013 më datën 04.11.2013



**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*